



SHPALLJE E REKRUTIMIT

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, shpallë konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës:

ZYRTAR I LARTË I KADASTRIT

Drejtoria: Drejtoria për urbanizëm, kadastrë dhe mbrojtje të mjedisit –

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: koeficienti 7.

Numri i referencës së vendit të punës: 16-9039/14

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Mirëmbajtja e kadastrit etazher
2. Mirëmbajtja e sistemit të adresave
3. Mirëmbajtja e dokumentacionit zyrtar të pasurisë shoqërore
4. Ndiemon rreth procedurës marrjen e masave me qëllim të rregullimit juridik të pasurisë shoqërore,
5. Përpunon shënime statistikore për paluajtshmëri
6. Bënë mirëmbajtjen dhe azhurnimet e të gjithë pasurisë komunale, shoqërore dhe private
7. Lëshon certifikata të pasurisë sipas nevojës së palëve
8. Mirëmbajtjen e librave të RDPP-së dhe hipotekave
9. Ekzekutimin e vendimeve
10. Kryen detyra tjera të për caktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Diplomë Universitare , Fakulteti i Gjeodezisë
- Të kenë më së paku dy vite përvojë pune(e preferuar)
- Trajnime profesionale në lëmin e kadastrit(Autocad, Aris, KCLIS, Geomedia)
- Të ketë aftësi profesionale dhe të njoh mirë operatin kadastral
- Të ketë aftësi në zgjedhjen e problemeve në mënyrë të pavarur
- Njohuri të mira në përdorimin e softuerëve zyrtar
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze
- Të ketë aftësi komunikimi me palë.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit : Me afat të pacaktuar

Data e mbylljes së konkursit; Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimores **-Zyra e pranimit**, kati përtheshë dhe ne web-faqen komunale .

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomën e Fakultetit të kryer apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, Dëshmi për përvojën e punës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes, certifikata mbi trajnimet e kryera, Çertifikatën shëndetësore me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore, dëshminë se nuk është në hetime.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi